



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	27.07.2026	14.08.2026	2026/0522

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.07.2026, OE “SMART ENG GROUP SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0522, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Mondi SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rindertimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindertimi dhe renovimi i salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejes LOT 3 Rindertimi dhe renovimi i strehes ne sallën e sporteve te shkolles Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindertimi dhe renovimi i shkolles SHMFU Pjeter Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit te salles se sportit ne shkollen fillore Lidhja e Pejes” me nr. të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlere e parashikuar e kontrates per lot.2: **52.070.00** €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji me nr. 04/L-042, per Prokurim Publik

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 52 - Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

apo

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SMART ENG GROUP SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

Neni 130- Ndikimi i paligjeshëm.

Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 40- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 97- Shkeljet e rënda të LPP-se

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues -Komuna Pejë- Zyra e Prokurimit për këtë procedurë të prokurimit fillimisht me datën 10.07.2026, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, formularin B58 dhe për lotin 2, ka rekomanduar për dhënie të kontratës kompani të pa përgjegjeshme.

Kundër këtij vendimi nëse kompani me datën 15.07.2026, kemi parashtruar kërkesë për të shqyrtim dhe kemi prezantuar prova dhe fakte për veprime kundërligjore, përderisa AK - Komuna Pejë, të nesërmen apo me datën 16.07.2026, nxjerre vendim dhe refuzon kërkesën tone si të pa baze, përderisa pretendimet ankimore fare nuk i trajton, prandaj bazuar në nenin 109, të LPP-se paraqesim faktet tona si më poshtë:

Pretendimi ankimore 1.

AK- Komuna Pejë, me vendimin e datës 16.07.2026, ka refuzuar kërkesën tone për Rishqyrtim pa e analizuar dhe pa e arsyetuar asnjë nga pretendimet tona ankimore të përfshira në kërkesë për ri shqyrtim, duke u mjaftuar me fjalinë përgjithësuese se "pretendimet janë të njëanshme" !!!

Mungesa e analizimit të provave dhe jo përgjegjësia zyrtare nga AK, përkatesisht zyra e

prokurimit, përbën shkelje thelbësore procedurale që cenon të drejtën kushtetuese, mbrojtjes dhe barazine administrative.

Potencimi i AK-së se ankuesi mban renditjen e katert, nuk e largon atë nga e drejta e kontestimit të ofertave tjera të papërgjegjshme që renditen para, dhe mos trajtimi i 16 pretendimeve tona ankimore të paraqitura në kërkesë për ri shqyrtime shkele në tërësi nënin 108/A të LPP-se, marrë parasysh faktet se në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në aneksin 7 të FDT-së kërkohet shprehimisht që pajisjet duhet të dëshmojnë me librezat valide të regjistrimit.

- "O.E të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen".

Operatori fitues "Mondi SH.P.K." nuk ka dorëzuar librezat valide të qarkullimit për kamionin me kran, kipperin dhe furgonin dhe AK e ka anashkaluar në mënyrë të paligjshme këtë kriter kualifikues të përcaktuar nga vetë ai dhe se natyra e punimeve për Lotin 2, konsiston në renovimin e dyshemesë dhe parketit "Bung" të sallës së sportit sipas pikes 9.1 & 9.2 të FDTse, ku prag minimal është përcaktuar vlera prej 75,000.00 €, ndaj projekteve të realizuara dhe se të gjitha referencat e dorëzuara nga OE "Mondi SH.P.K." ndërlidhen ekskluzivisht me ndriçim publik, çerdhe, trotuare dhe kanale ujtiqe.

Ndërtimi i trotuareve apo kanaleve nuk përbën "punë të natyrës së ngjashme" me instalimin dhe strugimin e parketit specifik sportive, prandaj AK – Komuna Peje, kunderligjeshëm ka rekomanduar për dhënie të kontratës kompaninë e propozuar për dhënie në lotin 2,

Pretendimi ankimore 2 në idy

Nga shqyrtimi i Policisë së Sigurimit "PRISIG", nr. 10001263522 dhe dokumentacionit 4/10

shoqërues, rezulton se oferta është përgatitur dhe dorëzuar nga Grupi i OE: "Mondi SH.P.K. One-Grup SH.P.K.", ndërsaq, AK- Komuna Peje, e ka rekomanduar për kontratë vetëm "Mondi SH.P.K." si operator individual ku ndryshimi i strukturës së grupit pas dorëzimit të ofertës cenon rëndë nënin 57 të LPP-së dhe parimin e barazisë dhe për këso veprimesh

kundërligjore komisioni vlerësues i ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit do duhej të viheshin para përgjegjësive ligjore ashtu siç përcaktohet me nenin 25 dhe 59.1 të LPP-se.

Pretendimi ankimore 3

Oferta e OE Mergant Ing shpk është e pa përgjegjeshme pasi që kërkesa e dosjes së tenderit gjegjësisht sipas pikës 22.1 dhe parimeve të platformës e-Prokurimi, të gjitha dokumentet kualifikuese që përbëjnë tenderin duhet të dorëzohen në formate të pandryshueshme dhe të skanuara zyrtarisht që garantojnë integritetin e nënshkrimit dhe vullës së Operatorit Ekonomik.

Në ofertën e OE të rekomanduar në lotin 1, deklarata nën betim apo aneksi 2 dhe dokumentet e tjera janë dorëzuar plotësisht në format të modifikueshëm apo Word, ku dorëzimi i dokumenteve bazike dhe kualifikuese në format Word, ku nënshkrimi dhe vula mund të manipulohen apo ndryshohen me lehtësi pas afatit të dorëzimit të ofertave, cenon parimin e integritetit të ofertës dhe barazisë dhe kjo e bën ofertën administrativisht të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 2.

Në FDT, pikën 9.1 & 9.2 shprehimisht kërkohej që Operatori duhet të dëshmojë kontrata të përfunduara me sukses për projekte të natyrës së ngjashme në 3 vitet e shkuara dhe se natyra e ngjashme për lotin 2 specifikon rreptësisht punimet e parketit si heqje, montim, gërryerje në 5 faza, llakim me standarde FIBA dhe se në ofertën e OE Mergant Ing shpk, i kualifikuar si i përgjegjshëm por i pa suksesshëm, e vetmja kontratë që specifikon punë parketi është ajo e komunes së Lipjanit me vlerë vetëm 5,633.33 euro, ndërsa kontratat tjera të deklaruara kanë të bëjnë me renovime bodrumesh, gëlqerosje institucionesh, ose renovime zyrash të pensioneve, të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme me parket siç është objekti i kësaj kontrate perkatese.

Kompania ka vetëm 5,633.33 €, përvojë specifike në parket dhe shumën e kontratave të tjera për gëlqerosje dhe izolime nuk mund të përlogaritet si përvojë e ngjashme për

dysHEME sportive FIBA, pra operatori dështon të mbërrijë pragun e kërkuar për lotin 2.

Pretendimi ankimor 3. SM

Në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe FDT, përkatësisht në dëshminë nr. 4, është kërkuar që pajisjet motorike duhet të dëshmohen me kopje të librezave të qarkullimit ku vërtetohet se janë valide dhe të regjistruara. Në ofertën e OE të Migrant Ing shpk, në certifikatën e regjistrimit të automjetit "Caddy" furgon me targa 01-499-NO, të ngarkuar nga kjo kompani, vërehen ndërhyrje të qarta manuale tek data e vlefshmërisë dhe të nënshkrimit zyrtar të vulës dhe se nëni 6.3 pika k) e DT-së dhe nëni 65 i LPP-së ndalojnë rreptësisht dorëzimin e dokumenteve me përmbajtje të ndryshuar, të rreme apo mashtruese dhe se çdo ndërhyrje manuale mbi një dokument zyrtar shtetëror apo libeze të qarkullimit

5/10

rrugore e bën atë të pavlefshëm dhe sjellë diskualifikimin e menjëhershëm të operatorit, madje ligjerisht juve si AK do duhej të ndermerrnit veprime ligjore në kuptim të nenit 99.2 të LPP-së dhe jo të rekomandonit për dhënie të kontratës ofertën e tillë.

Pretendimi ankimor 4.

Në dosje të tenderit përkatësisht oken 9.1 & 9.2 të FDT-së, kërkohet angazhimi i minimum 8 punëtorëve teknikë të përshtatshëm për realizimin e projektit dhe se O? Mergant shpk, në listën e të punësuarve dhe kontratat e punës të dorëzuara, ka ofruar profilet si, Moler - Fasader, teknik i ujësjellësit, teknik i ujësjellësit dhe kanalizimit, ndihmës moler-fasader dhe teknik i elektroteknikës. Pra asnjë punëtor i vetëm i tyre nuk është i certifikuar apo i profilin parketar ani pse objekti i kontratës dhe punët e kërkuara në lotin 2, konsistojnë ekskluzivisht në vendosjen dhe strugimin profesional të parketit të sallës së edukatës fizike dhe se ofrimi i stafi të përbërë nga molerë, elektrikistë dhe hidraulikë nuk garanton realizimin e punëve specifike sipas standardeve FIBA dhe bie nënsh me nenin 59 të LPP-së dhe kjo qeshtje fare nuk është trajtuar nga AK - Komuna e Peje sipas kërkesës sonë për rishqyrtim.

Pretendimi ankimore 5.

Oferta tjetër e OE Hajrush Shoshi BI, e kualifikuar si e përgjegjeshme në lotin 2, është në tërësi e pa përgjegjeshme pasi që në FDT, për Lot 2, AK – Komuna Peje ka kekruar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për projekte të natyrës së ngjashme, me vlerën e përcaktuar si në dosje të tenderit ku si dëshmi është kërkuar plotësimi i aneksit 6, të cilit duhet ti bashkëngjiten referencat dhe certifikatat e kryerjes së punëve ku saktësohet vlera, data dhe vendndodhja.

Në ofertën e OE Hajrush Shoshi B.I., është prezantuar një kontratë bashkëpunimi me kompaninë "CTA" SH.P.K për projektin "Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrell - Vazhdim", mirëpo, ky angazhim ka qenë në cilësinë e nënkontraktorit dhe për të vërtetuar vlerën faktike të punëve të kryera nga vetë ai, operatori nuk ka bashkëngjitur asnjë situacion teknik të nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe asnjë faturë financiare, por ka dorëzuar vetëm një pasqyrë të qarkullimit bankar të NLB Bankës. Pra pasqyra e thjeshtë e qarkullimit bankar tregon vetëm transaksione monetare apo hyrje parash, por nuk përbën dëshmi që vërteton se cilat pozicione të punës janë ekzekutuar, në çfarë cilësie dhe në çfarë vlere, rrjedhimisht pa situacione zyrtare dhe fatura që ndërlidhen me librat e ndërtimit, është e pamundur të vërtetohet nëse ky OE, ka përmbushur pragun minimal të përcaktuar në dosje të tenderit, për punë të ngjashme të lotit 2, prandaj kjo referencë është pa verifikueshme dhe oferta duhet të shpallet e papërgjegjshme automatikisht por që quditerisht AK - Komuna Peje dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit as këtë pretendim ankimore nuk e ka trajtuar fare. SH.PK

e

Pretendimi ankimore 6.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit për lot-2, është kërkuar

As496414

që operatorët duhet të dorëzojnë:

"Dokumentacionin autentik i prodhuesit - katalogë. Pjesë të katalogut të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrime teknike detale...". Po ashtu, kërkohet që llaku dhe modeli i parketit të plotësojnë standardet e FIBA-s me standard valid EN.

6/10

Në ofertën e Hajrush Shoshi B.I, është dorëzuar katalogu i prodhuesit Italian "Dalla Riva Sportfloors", për sistemet Compact 45 / Playwood Rubber 22, mirëpo, certifikata zyrtare e miratimit nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit FIBA - Certificate of Approval, e përfshirë në faqen 3 të këtij katalogu mban shënimin perkates si ne vijim: "VALID UNTIL 31 DECEMBER 2020" - E vlefshme deri më 31 Dhjetor 2020.

Duke qenë se aktualisht jemi në vitin 2026, certifikata e atestit të FIBA-s për materialin e ofruar ka skaduar para më shumë se 5 viteve dhe se ky dokumentacion nuk dëshmon vlefshmëri aktuale të certifikimit të prodhuesit për këtë periudhë. Sipas pikës 3.2 të Dosjes së Tenderit, "Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikojë tenderin", prandaj, ofrimi i një produkti me certifikim të skaduar e bën ofertën teknikisht të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 7.

Operatori Ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës në lotin 2 "Mondi Shpk, është tërësisht i pa përgjegjshëm pasi që në FDT 8.1 & 8.2 është kërkuar që Operatori Ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme tatimore se qarkullimi vjetor gjatë tri viteve të fundit financiare ka qenë jo më pak se 100,000.00 Euro. Si dëshimizim kërkohen "Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës".

Në Ofertën e OE të propozuar në lot 2, tek formulari i deklaramit të qarkullimit vjetor nga ATK mungon plotësisht dhe nuk është i përfshirë në mjetet e ruajtjes së të dhënave CD deklarata tatimore dhe se pa këto deklarata tatimore, është e pamundur të vërtetohet nëse kompania e përmbush pragun financiar prej 100,000.00 euro ku sipas pikës 6.4 të FDT-së, dështimi në dorëzimin e dokumentit i jep të drejtë AK-së ta refuzojë ofertën si të

papërgjegjshme dhe AK - Komuna Peje pavaresisht ketije fakti nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për eliminimin e kesaje oferte, perkundrazi e ka rekomanduar për dhenin e kontratës.

Pretendimi ankimore 8.

Ne FDT pike 9.1 & 9.2, për Lot -2, kërkohet që inxhinieri apo Menaxheri i Projektit të ketë diplomën, CV-në, kontratën si dhe "vendimin për projekt menaxher të vulosur dhe nënshkruar nga Kompania", por që "Mondi Shpk, nuk ka dorëzuar asnjë vendim zyrtar të shkruar dhe të nënshkruar për caktimin dhe emërimin e inxhinierit në këtë projekt specifik dhe se mungesa e vendimit të emërimit përbëne mospërbushje të plotë të formës dhe kërkesës së kualifikimit profesional të përcaktuar shprehimisht si obligative në dosjen e tenderit. SM m

Pretendimi ankimore 9.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional për inxhinierin e kërkuar master i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv me së paku 5 vite përvojë, kërkohet që CV-ja e tij të jetë e "dokumentuar me trust", ndërsa në ofertën e OE të propozuar për lotin 2, mungon pasqyra zyrtare e llogarisë së Trustit Pensional për personin e propozuar si menaxher projekti, rrjedhimisht dokumentimi i CV-së përmes trustit është mjeti i vetëm objektiv i kërkuar nga AK për të vërtetuar përvojën reale të punës pas diplomimit dhe se mungesa ?

7/10

tij e bën kërkesën të paverifikueshme dhe ofertën të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimore 10.

të

OE i propozuar për dhënie në lotin 2, ka dorëzuar listën së Punëtorëve të pa nënshkruar edhe pse kërkesa e dosjes së tenderit apo pjesa A - Informacion për Tenderuesit, përcakton qarte që të gjitha listat, formularët dhe deklaratat e hartuara nga Operatori Ekonomik duhet të dorëzohen të plotësuar, të nënshkruara dhe të vulosura rregullisht. Lista e stafit

punëtorëve të angazhuar të dorëzuar nga "Mondi" SH.P.K, është plotësisht e p?

nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor dhe një dokument i pa nënshkruar nuk ka vlefshmëri juridike dhe nuk e obligon operatorin, prandaj komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk mund të trajtojë si të rregullt një listë që nuk është konfirmuar me nënshkrim apo pa e bashkangjitur autorizimin perkates në oferte siç kerkohet me dispozita ligjore në fuqi. Pretendimi ankimor 11.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional për pajisjet e kërkuara në aneksin 7, shprehimisht është kërkuar që operatori duhet të dorëzojë kopjet e librezave valide të qarkullimit për të dëshmuar se janë të regjistruara dhe kanë sigurim. DT specifikon qarte se OE, të cilët nuk i kanë pajisjet e regjistruara eliminohen nga ky Aktivitet i Prokurimit dhe se në ofertën e OE Mondi SH.P.K, nuk është dorëzuar librezat valide të qarkullimit dhe regjistrimit për makineritë kryesore si kamionin me kran, kamionin kipper dhe furgonin. Ky është një kriter kualifikues i qarte në dosje dhe se ofrimi i mekanizmit pa librezat të regjistrimit sjell skualifikimin e menjëhershëm pa pasur mundësi sqarimi apo plotësimi dhe për rekomandim të ofertës së tillë komisioni vlerësues i ofertave është përgjegjës individualisht në kuptim të dispozitës ligjore të paragrafit 1 të nenit 59 të LPP-se.

Pretendimi ankimor 12.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit, pika 9.1 & 9.2, përcakton që operatori duhet të dëshmojë kontratën të përfunduar për projekte të natyrës së ngjashme në vlerë minimale prej 75,000.00 euro në 3 vitet e shkuara dhe duke qenë se loti 2, konsiston në renovimin e dyshemesë dhe parketit Bung të sallës së sportit, kontratat duhet të përgjigjen kësaj natyre, që në ofertën e OE të propozuar në lotin 2, përkatësisht në listën e kontratave të realizuara, operatorit "Mondi" SH.P.K, i mungojnë plotësisht referencat apo dëshmitë që dëshmojnë realizimin e punëve të parketit dhe se kontratat e tyre lidhen me ndriçim publik, ndërtim çerdheje, trotuare apo kanale ujitjeje, por nuk kanë asnjë referencë specifike për parket.

por

Punët e infrastrukturës rrugore, ndriçimit apo trotuareve nuk mund të vlerësohen si "punë të natyrës së ngjashme" për instalimin dhe strugimin e dyshemeve sportive të sallave të edukatës fizike, ku operatori ekonomik i propozuar në lotin 2, ka dështuar plotësisht të përmbushë kriterin e përvojës teknike dhe apo profesionale.

Pretendimi ankimor 13.

S

Kërkesa e Dosjes së Tenderit është kërkesë obligative dorëzimi?????? i katalogëve teknikë të vërtetuar nga prodhuesi për artikujt që ofrohen dhe se ky OE në fletë ka shënuar

8/10

tekstualisht se dokumentet shtesë i ka "dorëzuar fizikisht" pranë AK-së por që dorëzimi i dokumentacionit teknik në formë fizike jashtë platformës elektronike është shkelje administrative dhe ligjore, e cila cenon parimin e barazisë dhe se çdo dokument që mungon në sistemin elektronik konsiderohet i pa-dorëzuar dhe se mungesa e katalogëve të detyrueshëm ligjor do duhej të sjellte eliminimin e ofertës si të papërgjegjshme.

Pretendimi ankimor 14.

Sipas njoftimit mbi Vendimin e AK-së, kontrata për lot 2, i është dhënë vetëm kompanisë "Mondi" SH.P.K. si operator individual, mirepo nga shqyrtimi i kontratave të punës dhe dëshmive të sigurimit të ngarkuara apo policia e sigurimit nga KS PRISIG" me numër 10001263522, rezulton se ky operator ka aplikuar fillimisht si Grup i Operatorëve Ekonomik: "Mondi SH.P.K. & One-Grup SH.P.K." dhe se ndryshimi i përbërjes së grupit, apo shpërblimi i vetëm njërit anëtar pa pasur ndryshim zyrtar të lejuar para fazës së dhënies, bie ndesh me nenin 11.5 të kushteve të përgjithshme të Kontratës dhe me nenin 57 të LPP-se apo dhe parimin e trajtimit të barabartë, gjë që e bën vlerësimin e AK-së plotësisht të parregullt.

Pretendimi ankimor 15.

AK - Komuna Peje hapjen e ofertave për këtë projekt e ka realizuar më datën 19.05.2026, ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpërbllim me kontratë dhe eliminim është marrë dhe publikuar më datë 10.07.2026, ku kjo nënkupton se Komisioni i Vlerësimit ka konsumuar saktësisht 52 ditë kalendarike për të nxjerrë vendimin përfundimtar.

Ky aktivitet i prokurimit, specifikisht loti 2, nuk ka pasur asnjë element të kompleksitetit teknik apo financiar dhe se paramasa konsiston vetëm në pak pozicione dhe nuk ka pasur asnjë arsye objektive apo volum dokumentesh që do të arsyetonte një tejzgjatje prej 52 ditësh apo 22 ditë përtej afatit maksimal të lejuar ku është mbajtur e bllokua procedura në mënyrë të paligjshme, duke shkelur parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit të prokurimit publik.

Si përfundim, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të ofertave bazuar në nenin 59.1 të LPP-së, mbajnë përgjegjësi individuale ligjore për ekzaminimin objektiv dhe jo konform

kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit, ku favorizimi i OE të propozuar për dhënie të kontratës në lotin 2, është e sanksionuar edhe me nenin 97, të RrPP-së, marrë parasysh edhe faktin se zyrtari përgjegjës i Prokurimit ka nxjerrë vendim shablon, të përgjithësuar dhe të paarsyetuar dhe pa e trajtuar asnjë prej 16 pretendimeve ankimore.

Prandaj për të garantuar pa anësinë e këtij procesi të prokurimit kërkojmë që OSHP, në kuptim të nenit 113 të LPP-së të caktoj ekspert shqyrtues të pavarur dhe të paaneshëm i cili do të trajtoj të gjitha pretendimet tona ankimore për lotin 2 në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerrë këtë;

VENDIM

SH.P ???????

I. Të aprovohet në tërësi e bazuar ankesa e OE "Smart Eng Group" shpk, si

9/10

e bazuar;

II. Të anulohet, njoftimi i datës 10.07.2026, formulari B58, propozimi për

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SMART ENG GROUP SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

dhenien e kontratë dhe loti 2, të kthehet në Ri-vlerëim.

III. Të lejohet, kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës.

Të gjitha këto prova tregojnë për tentative abuzimi me parane publike, keqpërdorimin dhe mashtrimin në prokurim Publik dhe detyrë zyrtare, prandaj kërkojmë përgjegjësi ligjore

dhe profesionale me rastin e trajtimit të kësaj ankesë .

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit - FDT

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDFIMI MBI RISHQYRTIM)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SMART ENG GROUP SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Pergjigja nga AK

Autoriteti Kontraktues konstaton se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës, ekonomicitetit dhe konkurrencës së drejtë. Komisioni i Vlerësimit, në përputhje me nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave të dorëzuara, duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Nga Raporti i Vlerësimit rezulton se:

- për LOT 1, Operatori Ekonomik SMART ENG GROUP SH.P.K. është renditur i teti (8) sipas çmimit të ofertuar;
- për LOT 2, Operatori Ekonomik SMART ENG GROUP SH.P.K. është renditur i katërti (4) sipas çmimit të ofertuar.

Rrjedhimisht, operatori ankues nuk është operatori ekonomik me ofertën më të favorshme ekonomike dhe nuk është i renditur menjëherë pas operatorëve të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Edhe në rast hipotetik të pranimit të ndonjërit prej pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, kjo nuk do të rezultonte automatikisht me shpalljen fitues të Operatorit Ekonomik SMART ENG GROUP SH.P.K., pasi para tij janë të renditur operatorë të tjerë ekonomikë me oferta me çmime më të ulëta, të cilët do të duhej të vlerësoheshin sipas radhës së renditjes dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Lidhur me pretendimet e paraqitura në pikat 1 deri në 16 të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konstaton se ato janë pretendime të njëanshme të operatorit ankues dhe nuk mbështeten me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se operatorët ekonomikë të rekomanduar nuk i plotësojnë kriteret e Dosjes së Tenderit.

Komisioni i Vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin administrativ, ekonomik, financiar, teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë të rekomanduar dhe ka konstatuar se të njëjtit i përmbushin kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimet lidhur me formatin e dokumenteve të dorëzuara, deklaratat tatimore, kontratat e natyrës së ngjashme, personelin profesional, pajisjet, katalogët teknikë, certifikimet, dokumentacionin e automjeteve, listën e stafit, përvojën profesionale dhe dokumentacionin tjetër janë shqyrtuar gjatë procesit të vlerësimit dhe nuk është konstatuar asnjë mangësi që do të përbënte shkak për shpalljen e ofertave si të papërgjegjshme.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SMART ENG GROUP SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbështesë vendimmarrjen vetëm në pretendimet e operatorit ankues, pa prova konkrete dhe pa u bazuar në dokumentacionin zyrtar të dorëzuar në procedurën e prokurimit.

Sa i përket pretendimit lidhur me kohëzgjatjen e procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues vlerëson se ky pretendim nuk ndikon në ligjshmërinë e vendimit për dhënie të kontratës. Procesi i vlerësimit është zhvilluar në funksion të sigurimit të një ekzaminimi të plotë dhe objektiv të të gjitha ofertave dhe nuk ka cenuar konkurrencën apo trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues rikujton se sipas Dosjes së Tenderit kriter për dhënien e kontratës ka qenë **oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët**.

Për LOT 1, kontrata i është rekomanduar operatorit ekonomik që ka ofertuar çmimin më të ulët dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për LOT 2, kontrata i është rekomanduar operatorit ekonomik që ka ofertuar çmimin më të ulët dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat administrative, ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale.

Me këtë vendim Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe ka siguruar përdorimin racional, ekonomik dhe efikas të mjeteve publike.

Duke qenë se kërkesa për rishqyrtim nuk provon asnjë shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik dhe asnjë shkelje të kërkesave të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk ekziston asnjë bazë ligjore për anulimin ose ndryshimin e Vendimit mbi Dhënien e Kontratës.

Për këto arsye, kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik SMART ENG GROUP SH.P.K. **REFUZOHE**t si e pabazuar, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP- se duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor .

Merespekt

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "SMART ENG GROUP SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës" me numër të prokurimit: "635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - SMART ENG GROUP SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Fillimisht sqarojmë se pretendimet ankimore sipas ankesës 522/26 janë parashtruar kundrejt 3 operatorëve ekonomik të renditur me çmim më të ulët se OE ankues

Pas analizimit të shkresave të lëndës, kërkesës për rishqyrtim, vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, si dhe ankesës të parashtruar në OSHP, kemi gjetur se OE ankues përmes kërkesës për rishqyrtim sa i përket Lot.2 (për të cilin ka ushtruar ankesë në OSHP) ka ngritur pretendime ankimore vetëm kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Kjo është theksuar edhe nga AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, ku AK potencon se OE në fjalë renditet i katërti me çmim dhe e refuzon kërkesën për rishqyrtim pa i trajtuar pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP për lot.2, OE ankues tani ngrit pretendime ankimore edhe kundrejt dy OE-ve të tjerë të renditur me çmim më të ulët se OE ankues.

Eksperti shqyrtues jep mendim se ngritja e pretendimeve ankimore të reja, kundrejt dy OE-ve të tjerë të cilat nuk kanë qenë në kërkesë për rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 64 par.2 të Rregullores për Prokurim Publik, ku decidivisht kërkohet që : *"64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar "Ankesat". **Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.**"*

Mbi këtë bazë eksperti shqyrtues nuk mund të vlerësojë se vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar, përderisa kërkesa për rishqyrtim nuk ka pasur pretendime ankimore kundrejt dy OE-ve tjerë për lot.2, dhe pretendimet ankimore në ankesë nuk janë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se.

Megjithatë vlen të theksohet se OE i renditur i dyti me çmim për lot.2, është OE i rekomanduar për kontratë për lot.1, dhe sipas dosjes së tenderit një OE mund të shpërblehet vetëm për një Lot të këtij aktiviteti të prokurimit, çka rezulton se OE ankues përveç OE të rekomanduar për kontratë ka vetëm edhe një OE tjetër (përveç OE fitues) i cili është me çmim më të ulët se OE ankues, megjithatë OE

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SMART ENG GROUP SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

ankues nuk ka ngritur pretendime ankimore as për këtë OE në kërkesë për rishqyrtim për lot.2.

Vlerësojmë se AK në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A pasi nuk ka trajtuar pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, kjo pasi përgjigjet si "nuk është konstatuar asnjë mangësi", ose "OE irekomanduar i plotëson kërkesat" nuk jep asnjë lloj kunderargumenti ndaj pretendimit ankimor. Po ashtu nuk qëndron deklarimi i AK-së se OE ankues ka edhe dy OE tjerë me çmim më të ulët, pasi OE i dytë me çmim veç se është i rekomanduar për kontratë për lot.1 dhe nuk mund të rekomandohet për tjera lote.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, vlerësojmë se vendimi i AK-së nuk është marrë në pajtim me nenin 108/A të LPP-së par.8.4, pasi autoriteti kontraktues nuk ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart rekomandojmë që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “SMART ENG GROUP SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rindërtimi dhe renovimi i shkollave dhe anekseve LOT 1 -Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit IAAP Rifat Gjota LOT 2 Rindërtimi dhe renovimi i sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës LOT 3 Rindërtimi dhe renovimi i strehës në sallën e sporteve të shkollës Lidhja e Prizrenit LOT 4 Rindërtimi dhe renovimi i shkollës SHMFU Pjetër Budi, Dardania 3 LOT 5 Renovimi i kulmit të sallës së sportit në shkollën fillore Lidhja e Pejës” me numër të prokurimit: “635-26-2916-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **SMART ENG GROUP SH.P.K.**



Ilir Halili